



Ambasciata d'Italia  
Tirana



unicef   
for every child

## **TË RINJTË NË VEPRIM: ARSIM, PUNËSIM DHE TRAJNIM PËR TË GJITHË!**



# Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në partneritet me UNICEF-Shqipëri, pilotoi ngritjen e një praktike pune për identifikimin dhe menaxhimin e të rinjve NEET1 në nivel lokal, në bashkinë e Elbasanit, në periudhën Shtator 2023-Dhjetor 2024.

Komponentët kryesorë në të cilat u pilotua ngritja e praktikës së punës ishin:

## 1. Krijimi dhe konsolidimi i Grupit Koordinues Lokal për NEET në Elbasan

Ngritja e këtij grupi koordinues në nivel vendor pranë zyrës së Drejtorisë Rajonale të Agjencisë Kombëtare të Punësit dhe Aftësive (DR-AKPA) filloi me pjesëmarrjen e disa prej përfaqësuesve në nivel vendor të cilët përfshinin arsimin dhe mbrojtjen sociale. Takim pas takimi, lindte nevoja që ky grup të zgjerohej dhe me aktore të tjerë vendore, duke bërë që deri më sot, pjesë e këtij grupi koordinues lokal për NEET të jenë:

- Arsimi, të cilët në këtë grupim përfaqësohen nga:
  - zyra arsimore vendore
  - drejtues të shkollave që kanë arsim bazë me kohë të pjesshme dhe gjimnazi me kohë të pjesshme
  - pedagogu për orientim karriere, pjesë e Universitetit të Elbasanit.
  - mësues të shkollës/ve të mesme, kryesisht ato që merren me orintim karriere
- Mbrojtja sociale, ku është punonjësi për mbrojtjen e fëmijëve, pranë njësisë për mbrojtjen e fëmijëve në bashkinë Elbasan.
- Përfaqësues nga Zyra e punës pranë Bashkisë Elbasan.
- DR-AKPA, I cili është dhe institucioni që fton, organizon takimet në ambientet e tyre dhe koordinon proceset rast pas rasti.
- Qendra e Formimit Profesional Elbasan, - të cilët ofrojnë kurset dhe trajnimet kualifikuese për persona mbi 15 vjec, duke përcaktuar dhe evidentuar kriteret përkatëse sipas kushteve dhe interesave të personave NEET.
- Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore - agjenci vendore e rëndësishme për të evidentuar të gjithë detyrimet Ligjore dhe hapësirat e mundshme, në rast interesi për punësim personi mbi 16 vjeç dhe nën 18 vjeç.
- Organizata të shoqërisë civile të angazhuar në nivel vendor për çështjet e të rinjve dhe punësimin;
- Përfaqësues rinor nga dy këshillat vendor në Elbasan që janë:
  - a. Këshillit Vendor Rinor
  - b. Këshillin Rinor
  - c. Specialisti/ punonjësi i rinisë pranë Bashkisë Elbasan

Qëllimi i krijimit të këtij grupi është identifikimi dhe mbështetja e të rinjve, të cilët nuk kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm dhe ata që nuk janë as në arsim, trajnim profesional apo punësim, duke i referuar këto raste në arsimin e mesëm apo qendrat e formimit profesional.

## 2. Konsolidimi i Grupit Koordinues Lokal për NEET

Që prej themelimit të tij, grupi u formalizua në mënyrë zyrtare duke identifikuar një person kontakti nga secili institucion pjesëmarrës, me qëllim lehtësimin e komunikimit ndërmjet institucioneve vendore, reduktimin e burokracive dhe zbatimin e afateve kohore.

Grupi Koordinues Lokal për NEET në Elbasan, është mbledhur periodikisht, duke shkëmbyer informacion për identifikimin dhe ndërmarrjen e veprimeve për të përmbushur nevojat e të rinjve NEET.

Kjo kartolinë u përgatit nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve në zbatim të programit “Arritja e të paarriturve 2”, në kuadër të projektit “QENDRO në shkollë” financuar nga qeveria italiane nëpërmjet Ambasadës Italiane në Tiranë dhe zbatuar nga UNICEF.